STATUTI

I

ANSAMBLIT ARTISTIK TË KËNGËVE DHE VALLEVE

k komunes 4035
01 07.02.20

DEÇAN, Janar 2020

Bazuar në nenin 11 dhe nenin 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, sipas nenit 4, pika 1.1.2, nenit 5 paragrafi 2, nenit 23 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve " Shota" dhe për Ansamblet e Tjera Nr. 04/L-164, si dhe nenit 15 pika 18 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me datë 31.01.2020, miraton:

STATUTIN
E
ANSAMBLIT ARTISTIK TË KËNGËVE DHE VALLEVE

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Themelimi, Emërtimi dhe Selia

Me këtë Statut, rregullohet Statusi Juridik, i Ansamblit Artistik të Këngëve dhe Valleve në komunën e Deçanit, qëllimi, veprimtaria, organizimi i brendshëm, konstituimi dhe funksionimi i organit drejtues, mënyra e zgjedhjes, detyrat, vendim marrja dhe përgjegjesitë e Drejtorit, Këshillit Artistik, stafit, trupit artistik dhe mënyra e financimit (në tekstin e mëtejmë: AAKV).

Neni 2

Statusi Juridik i Ansamblit Artistik të Këngëve dhe Valleve (AAKV)

Themeluesi i Ansamblit Artistik të Këngëve dhe Valleve (AAKV) është Kuvendi i Komunës së Deçanit me Vendimin Nr. 01.Nr. VIII-6, datë: 27.09.2019 dhe Nr. Prot. 01/35177, datë: 14.10.2019.

Neni 3

Qëllimi

1. Ansambli Artistik i Këngëve dhe Valleve (AAKV) ka si qëllim realizimin e aktiviteteve kulturore të cilat, përmes këngëve dhe valleve, koreografive të ndryshme të ruajnë dhe kultivojnë, traditën, doket dhe zakonet e komunës së Deçanit dhe të trevave tjera Shqiptare.

2. Përmes këngëve dhe valleve, të kultivoj dhe promovoj kulturën e popullit tone-Shqiptar.

3. Të siguroj, ruaj dhe prezantoj kostumet-veshjet popullore me elemente etnografike të komunës së Deçanit dhe të gjitha trevave Shqiptare.

Njeni 4

1. Ansambli Artistik i Këngëve dhe Valleve (AAKV) ka Status të personit Juridik, të drejtat dhe përgjegjesitë qe i takojnë me Ligjin Nr. 04/L-164 për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve "Shota" dhe për Ansamblet e tjera me ketë Statut dhe Vendimin e Kuvendit të Komunës së Deçanit.

2. Pasuria (asetet) e Ansambli Artistik i Këngëve dhe Valleve (AAKV) janë pronë e komunës së Deçanit.

3. Raportet me palët Ansambli Artistik i Këngëve dhe Valleve (AAKV) prezantohet në emër dhe llogari duke u bazuar në dispozitat e ligjeve në fuqi.

4. Ballina hyrëse e objektit ku ushtrohet veprimtaria e Ansamblit Artistik të Këngëve dhe Valleve (AAKV), vendoset me mbishkrimin e gjuhëve zyrtare të parapare në Ligjin për Përdorim të Gjuhëve Zyrtare Nr. 02/L-37.

Neni 5

1. Ansambli Artistik i Këngëve dhe Valleve (AAKV) është institucion artistik-kulturor me seli në Deçan, në Rrugën "Jashar Salihu" Nr. 3, gjegjësisht në ndërtesën e Pallatit të Kulturës, "Jusuf Gervalla" .
2. Ansambli Artistik i Këngëve dhe Valleve (AAKV) ka emblemën e vete identifikuese e cila do të përzgjidhet me konkurs publik.

Neni 6

Monitorimin dhe mbikëqyrjen e rregullt të punës dhe zbatimin e ligjshmërisë së Ansamblit Artistik të Këngëve dhe Valleve (AAKV) e bën Kryetari i komunës dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sporte.

Neni 7

1. Ansambli Artistik i Këngëve dhe Valleve (AAKV) ka vulën e rrumbullaket dhe vulën katrore.

2. Vula e rrumbullaket është në diametër 40 mm dhe ka ketë përmbajtje:

   2.1 Rrethi parë: Republika e Kosovës;
   2.2 Rrethi i dytë: Komuna e Deçanit;
   2.3 Rrethi i trete: (AAKV)-Deçan;
   2.4 Mesi i vulës është emblema e AAKV-së.

3. Ansambli Artistik i Këngëve dhe Valleve (AAKV) ka vulën katrore të pranimit dhe dorëzimit të dokumentacionit me dimension të madhësisë 6 cm x 3.7 cm dhe ka ketë përmbajtje:

3.1 Republika e Kosovës;
3.2 Komuna e Deçanit;
3.3 AAKV-Deçan;
3.4 Numri i protokollit dhe data.

Neni 8

Ansambli Artistik i Këngëve dhe Valleve (AAKV) obligohet qe të ruaj dokumentacionin, mjetet e punës, rekuizitat, kostumet, instrumentet dhe të gjitha pasuritë tjera qe i takojnë ansamblit.

Neni 9

Veprimtaria e Ansamblit Artistik të Këngëve dhe Valleve (AAKV)

1. Veprimtaria e Ansamblit Artistik të Këngëve dhe Valleve (AAKV) përfshin:

1.1 Ruajtjen e traditës muzikore kombëtare;
1.2 Shfaqjen publike të koncerteve dhe formave tjera skenike dhe muzikore;
1.3 Organizimin dhe realizimin e koncerteve me tradita Shqiptare;
1.4 Arkivimin e lendeve muzikore, zhvillimin, avancimin dhe publikimin e artit brenda dhe jashtë vendit;
1.5 Përgatitjen, ngritjen dhe promovimin e talenteve të rinjë.

Neni 10

1. Ansambli Artistik i Këngëve dhe Valleve (AAKV) ruan, zhvillon, avancon, publikon artin Kombëtar brenda dhe jashtë vendit përmes:

1.1 Hartimit të politikave dhe propozimit të masave për ngritjen e cilësisë profesionale në fushën e artit skenik dhe muzikor;
1.2 Paraqitjes publike me koncerte skenike dhe muzikore me audio dhe video regjistrime dhe përmes materialeve tjera promovuese të programeve artistike Kombëtare;
1.3 Bashkëpunimit me ansamblet tjera vendore dhe ndërkombëtare.

Neni 11

Struktura dhe funksionimi i Ansamblit Artistik të Këngëve dhe Valleve (AAKV)

1. Struktura organizative e Ansamblit Artistik të Këngëve dhe Valleve (AAKV) përbëhet nga:

1.1 Drejtori;
1.2 Këshilli Artistik.

Neni 12

Drejtori i Ansamblit Artistik të Këngëve dhe Valleve (AAKV)

1. Drejtori i Ansamblit Artistik të Këngëve dhe Valleve është Udhëheqës i Ansamblit.

2. Drejtori i Ansamblit Artistik të Këngëve dhe Valleve, zgjidhet me konkurs publik, nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sporte.

3. Drejtori duhet të ketë Diplomë Universitare me përvojë të dëshmuar ne ketë lami.

4. Mandati i Drejtorit është katër (4) vjeçar me mundësi të rizgjedhjes.

Neni 13

1. Detyrat dhe përgjegjesitë e Drejtori i Ansamblit Artistik të Këngëve dhe Valleve.

   1.1 Drejtori i Ansamblit Artistik të Këngëve dhe Valleve, udhëheq, organizon dhe mbikëqyr veprimtarin dhe funksionimin e Ansamblit Artistik të Këngëve dhe Valleve.
   1.2 Drejtori i propozon, Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sporte, Planin vjetor të punës dhe Planin Vjetor Financiar si dhe raporton lidhur me realizimin e këtij plani.
   1.3 Kërkon fonde dhe negocion për marrjen e donacioneve.
   1.4 Ushtron detyra dhe autorizime tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 14

Drejtori i Ansamblit Artistik të Këngëve dhe Valleve për punën e tij e njofton Këshillin Artistik, ndërsa i përgjigjet drejtorit të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sporte.

Neni 15

Këshilli Artistik i Ansamblit Artistik të Këngëve dhe Valleve (AAKV)

1. Këshilli Artistik ka 3 (tre) anëtar, të cilët vijnë nga radhët e Ansamblit Artistik të Këngëve dhe Valleve.
2. Këshilli Artistik nga radhët e veta me shumice të votave zgjedh Kryesuesin.

Neni 16

Detyrat dhe përgjegjesitë e Këshillit artistik të Ansamblit Artistik të Këngëve dhe Valleve (AAKV)

1. Këshilli artistik të Ansamblit Artistik të Këngëve dhe Valleve ka për detyre:

1.1 Të hartoj, shqyrtoj dhe t'ia propozoj drejtorit programin artistik vjetor të Ansamblit Artistik të Këngëve dhe Valleve.
1.2 Të bëjë vlerësimin artistik të koncerteve dhe të aktiviteteve tjera kulturore dhe japë sugjerime, për konceptin e programit të Këshilli artistik të Ansamblit Artistik të Këngëve dhe Valleve.
1.3 Miraton programin artistik të Ansamblit Artistik të Këngëve dhe Valleve.
1.4 Kujdeset për prezantimin e vlerave të trashëgimisë kulturore.

Neni 17

1. Mbledhjet e Këshillit Artistik i thërret dhe Udhëheq Kryesuesi i Këshillit.

2. Në mungesë të Kryesuesit, mbledhjen e Këshillit Artistik mund ta thërrasë dhe udhëheq edhe njeri prej anëtareve të Këshillit të cilin e cakton Kryesuesi.

3. Këshilli Artistik i Ansamblit Artistik të Këngëve dhe Valleve, mund të punojë dhe marre vendime nëse në mbledhje janë të pranishëm shumica e anëtareve të këshillit 2/3.

Neni 18

Organizimi i Brendshëm

1. Ansambli Artistik të Këngëve dhe Valleve, është njësi organizative e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sporte dhe veprimtarinë e vete e realizon përmes sektorit administrativ financiar seksionit të valltarëve dhe këngëtarëve si dhe orkestrës.

2. Anëtarësimi i artisteve të rinjë, në Ansamblin Artistik të Këngëve dhe Valleve, bëhet përmes organizimeve të audicioneve dhe shpalljes publike të cilat parashikohen me rregullore të brendshme.

3. Punëtoret, artistet dhe performuesit tjerë si në piken 1 dhe 2 të këtij neni Drejtori me miratim paraprak të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sporte do të lidhë kontrate për punën e tyre e cila pune rregullohet bazuar në Ligjin e Punës dhe aktet tjera nënligjore dhe rregullore të brendshme.

Neni 19

Financimi

1. Ansambli Artistik i Këngëve dhe Valleve, financohet nga buxheti i komunës së Deçanit.

2. Ansambli Artistik të Këngëve dhe Valleve, mund të aplikoj me projekte për mbështetje financiare në konkurset vjetore të projekteve kulturore në Ministrinë për Kulturë, Rini dhe Sporte të Republikës së Kosovës.

3. Ansambli Artistik të Këngëve dhe Valleve, mund të financohet edhe nga burime tjera bazuar në legjislacionet në fuqi.

Neni 20

1. Kompensimet për stafin, mallrat, shërbimet dhe mjetet për investime kapitale menaxhohen nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sporte.

Neni 21

Mbikëqyrjen financiare, mbikëqyrjen e mbarëvajtjes së punëve dhe veprimtarisë së Ansamblit Artistik të Këngëve dhe Valleve, e bene themeluesi i autorizuar ligjor të paktën 1 (një) herë në vit.

Neni 22

Ansambli Artistik të Këngëve dhe Valleve, ka fondusin e vete dhe obligohet qe t'i ruaj kostumet, instrumentet muzikore, rekuizitat, elementet skenografike dhe materialet tjera me vlera etno-muzikologjike.

Neni 23

DISPOZITAT KALIMTARE

Organet drejtuese të Ansambli Artistik të Këngëve dhe Valleve, obligohen qe në afat prej 6 (gashtë) muajsh nga dita e miratimit të këtij Statuti, të nxjerrin Rregulloren për organizimin, detyrat dhe përgjegjesitë e punëtoreve të Ansambli Artistik të Këngëve dhe Valleve dhe Rregulloren për të drejtat dhe detyrimet e punëtoreve sipas projekteve.

Neni 24

Ky statut, hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi komunal dhe 15 (pesëmbëdhjetë) dite pas regjistrimit nga Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhet zyrtare në ueb-faqe zyrtare të komunës së Deçanit.

01.Nr.I-7
Deçan,dt.31.01.2020

Kryesuesi i Kuvendit:
Haki Shehaj